

# Franklin Learning Center High School

*-A Pennsylvania Blue Ribbon School of Excellence-*

*-Middle States Association Accredited School-*

616 N. 15<sup>th</sup> Street

Philadelphia, PA 19130

*Mrs. Nicole Lee, Drejtore*

*Dr. LaTrina Stewart, Ndihmes Drejtor*

*Mr. Anthony Guidice, Ndihmes Drejtor*

*215-400-7570,*

*215-400-7571 (fax)*

4 Gusht, 2021

Të dashur Prindër/Kujdestarë të klasave të 10 - ta,

**Mirë se vini përsëri në FLC dhe është kënaqësi e madhe që ju mirëpresim në ndërtesën tonë!** Shpresojmë që ju dhe familjet tuaja të keni pasur një verë të sigurt dhe të këndshme dhe se fëmijët tuaj të gjithë janë po aq të kënaqur sa ne për t'i takuar ata. Në një përpjekje për të mbështetur nxënësit tanë që kthehen në shkollë këtë vit, ne do të organizojmë një orientim për studentët dhe prindërit të Enjten, më 26 Gusht 2021 nga ora 9:00 e mëngjesit deri në 12:00 e drekës. Gjatë orientimit ne do t'ju prezantojmë studentëve dhe familjeve se cila është FLC si komunitet shkollor dhe çfarë do të thotë të jesh pjesë e komunitetit tonë. Aktivitetet do të përfshijnë prezantimin e Deklaratës sonë të re të Misionit, vlerat tona kryesore dhe aktivitetet e njohjes me ju.

Më poshtë janë datat për "Open Houses" për nxënësit dhe prindërit tanë të klasës së 9 -të dhe të 10 -të nga ora 9:00 e mëngjesit deri 12:00 e drekës. Studentët do të kenë mundësi të bëjnë fotografi për ID dhe të blejnë bluza uniforme.

Familjet gjithashtu mund të flasin me administratorët për protokollet COVID-19.

23-26 Gusht: "Open Houses" për klasat e 9 - ta dhe 10 - ta:

1. Studentët me Mbiemrin A - H: E Hënë, 23 Gusht
2. Studentët me Mbiemrin I - P: E Martë, 24 Gusht
3. Studentët me Mbiemrin Q - Z: E Mërkurë, 25 Gusht

Në një përpjekje për të mbajtur një formë të qartë komunikimi midis shtëpisë dhe shkollës, ne po kërkojmë që prindërit të shkojnë në faqen tonë të internetit, [flc.philasd.org](http://flc.philasd.org), dhe të plotësojnë formularin e Anketës së Informacionit të Prindërve në Google, në mënyrë që shkolla të komunikojë ngjarjet e ardhshme, takimet e rëndësishme dhe përditësimet drejtpërdrejt përmes emailit. Ne gjithashtu kërkojmë që të gjithë prindërit të regjistrohen në **Portalin e Prindërve** dhe nëse keni nevojë për ndihmë në regjistrim, mund të kontaktoni këshilltarin shkollor të fëmijës suaj kur të kthehen në punë më 23 Gusht.

**Studentët A - L Mr. Gist** ([agist@philasd.org](mailto:agist@philasd.org)) **Studentët M - Z Ms. Condit-Shaw**

([mcondit@philasd.org](mailto:mcondit@philasd.org))

## DEKLARATA E MISIONIT

*FLC është një komunitet shkollor gjithëpërfshirës i përkushtuar për të siguruar një trup të larmishëm studentësh me një edukim rigoroz dhe të përgjegjshëm ndaj kulturës që përgatit studentët me aftësitë profesionale dhe shoqërore që u nevojiten për të qenë anëtarë të shquar të komunitetit të qytetit, kombit dhe botës.*

# Franklin Learning Center High School

*-A Pennsylvania Blue Ribbon School of Excellence-*

*-Middle States Association Accredited School-*

616 N. 15<sup>th</sup> Street

Philadelphia, PA 19130

*Mrs. Nicole Lee, Drejtore*

*Dr. LaTrina Stewart, Ndihmes Drejtor*

*Mr. Anthony Guidice, Ndihmes Drejtor*

215-400-7570,

215-400-7571 (fax)

Si kujtesë, ngjarjet për vitin shkollor janë në FLC Google kalendar në faqen e internetit të shkollës sonë. Kalendarit azhurnohet vazhdimisht kështu që ne kërkojmë që ta kontrolloni në mënyrë të vazhdueshme. Familjet do të gjejnë ngjarje të veçanta, si “ **Back to School Night**” ditën e Mërkurë, 22 Shtator nga ora 5:30-8:00 pasdite. Në “ Back to school night” do t’u ofrojmë familjeve mundësi për t’u takuar me ekipin tonë të administratës, për të takuar mësuesit tanë dhe për të marrë pjesë në seminarët e mbajtura nga mësuesit tanë.

Ne presim një vit shkollor 2021 – 2022 të suksesshëm me ju dhe familjen tuaj. Si kujtesë, ne jemi në dispozicion për ju përmes emailit, telefonit ose takimeve në Zoom. Nëse keni ndonjë pyetje ose shqetësim në lidhje me këtë letër, ju lutemi mos ngurroni të kontaktoni Znj. Lee në [nlee@philasd.org](mailto:nlee@philasd.org).

Unë jam e gëzuar për t’u parë ju në” Open House” më 23 – 26 Gusht, në orientimin më 26 Gusht në 9:00 të mëngjesit, dhe në ditën e parë të shkollës e Martë, 31 Gusht në 7:55 am!

Sinqerisht,

*Nicole Lee*

Znj. Nicole Lee

Drejtore

## DEKLARATA E MISIONIT

*FLC është një komunitet shkollor gjithëpërfshirës i përkushtuar për të siguruar një trup të larmishëm studentësh me një edukim rigoroz dhe të përgjegjshëm ndaj kulturës që përgatit studentët me aftësitë profesionale dhe shoqërore që u nevojiten për të qenë anëtarë të shquar të komunitetit të qytetit, kombit dhe botës.*